

PËRSHKRIMI

Llaç riparimi i perforcuar polimer per riparimin e siperfaqes. Techno Fix 600 llaç i riparimit te betonit bruto me baze çimentoje dhe eshte komponent i vetem .

ZONA E PERDORIMIT

- Riparimi dhe nivelim siperfaqesor i elementeve te betonit me defekt siperfaqesor
- Perdoret per riparimin dhe suvatimin e siperfaqeve te ekspozuara te betonit.
- Per suvatimin dhe riparimin e mureve dhe tavaneve
- Perdoret per te marre nje siperfaqe te lemuar para hedhjes se qeramikes dhe pllakave.

KARAKTERISTIKAT

- Perdoret lehte ,perzihet vetem me uje
- Siguron perfundim te lemuar te siperfaqes
- Siguron aderance te larte te betonit dhe siperfaqeve te suvatuara
- Lehte per tu aplikuar pa çarje ne siperfaqe te medha
- Tregon veti te larte tiksotropike

PERGATITJA

Pergatitja e siperfaqes Duhet te sigurohet qe siperfaqja qe do riparohet te jete e forte ,mbajtese ,pa pluhur dhe e paster . Siperfaqja duhet te pastrohet plotesisht nga te gjitha llojet e mbetjeve të naftes, yndyrnave, ndryshkut dhe parafinës që mund te demtojne aderimin.Copezat prej hekuri dhe druri ne siperfaqe duhet të hiqen dhe boshlleqet deri ne 4 cm thellesi duhet te plotesohen me TECHNO FIX 600.Siperfaqja e aplikimit duhet te jete e ngopur me uje, por uji i lirë nuk duhet te mbetet ne siperfaqe.

PERZIERJA

Sasia e mjaftueshme e ujit hidhet ne nje kove te paster. TECHNO FIX 600 shtohet ngadale dhe perzihet me nje mikser 400-600 rpm per 4 minuta derisa te merret nje perzierje homogjene dhe pa gunga.E lejme ne gjendje qetesie per gati 4 minuta dhe pasi e kemi perzier perseri per 30 sekonda eshte i gatshem per aplikim

PERDORIMI

Llaçi i pergatitur aplikohet ne siperfaqe me nje mistri ne nje trashesi prej 5-30 mm. Llaçi pritet te terheqe ujin, me furçe suvatimi sperkatet uje mbi llaç dhe me mistri prej çeliku ose druri i jepet forma e deshruar .

Siperfaqe të medha te ekspozuara ne atmosferë, veçanerisht mjediset e nxehta, te thata ose me ere, duhet te mbrohen nga avullimi i shpejtë me thase te lagesht, uje ose agjente te veçante sherues per 24-48 ore pas aplikimit.

KUSHTET E RUAJTJES DHE PAKETIMI

Ai duhet te ruhet ne paketen e tij origjinale te pahapur ne nje mjedis te fresket dhe te thate te mbrojtur nga ngricat.Ne ruajtjen afatshkurter , mund te vendosen max 3 plaleta mbi njera-tjetren dhe duhet te zbatohet sistemi qe dergesa qe vjen e para te dale e para nga magazinimi.Ne depozitimin afatgjate paletat nuk duhet te vendosen mbi njera-tjetren. Shitet ne qeset kraft te perforcuara polietileni 25 kg'she.

INFORMACIONE MBI SIGURINE

Masat parandaluese qe zbatohen ne perdorimin e produkteve kimikate te zakonshme duhet te merren parasysh edhe ne perdorimin e ketij produkti .Gjate pushimit te punes ose ne perfundim te punes duart duhet te lahen me uje te bollshem ,nuk duhet te konsumohet ushqim ,pije apo te pihet cigare . Per perdorimin e ketij produkti dhe per transportin e tij ne dokumentin MSDS mund te gjendet informacion i personalizuar .

Per kete produkt per informacion te plote lidhur me çeshtjet e shendetit dhe sigurise duhet te aplikohet ne çertifikaten SDS .Ky produkt dhe kutia e tij duhet te hidhen ne perputhje me rregulloret lokale . Pergjegjes per kete eshte perdoruesi i fundit i produktit .